



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

Nr. 2021 Prot

Peshkopi, më 09.06.2022

Lënda: Dërgim vendimi

Drejtuar: Prefekti i Qarkut Dibër

Bashkëngjitur po ju dërgojmë për konfirmim Vendimin e Këshillit Bashkiak Dibër Nr.46

Datë 03.06.2022

“Për një shtesë në Vendimin nr.14 datë 08.04.2022 “Për miratimin e numrit të punonjësve të Administratës së Bashkisë, Institucioneve në vartësi dhe të Njërive Administrative për vitin 2022”.”

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Afrim Miki





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DIBËR

Nr.528/1.prot.

Peshkopi, më 10.06.2022


Lënda : Per vendimin nr. 46, datë 03.06.2022 të Këshillit të Bashkisë Dibër

Drejtuar : BASHKISË DIBËR

P E S H K O P I

Në mbështetje të ligjit nr.107/2016, date 27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut”, neni 16, pasi verifikova për efekt ligshmërie vendimin e Këshillit të Bashkisë Dibër nr.46, date 03.06.2022 “Për një shtesë në VKB nr.14, datë 08.04.2022 “Për miratimin e numrit të punonjësve të Administratës së Bashkisë, Institucioneve në varësi dhe të Njësive Administrative për vitin 2022, vendosa :

Miratimin në parim të aktit administrative objekti verifikimi dhe shqyrtimi në kushtet e zbatimit të legjislacionit aktual që rregullon marrëdhëniet juridike në fushën e punësimit dhe finances duke respektuar disiplinën financiare të parashikuara në dispozitat ligjore konkrete, veprime që kundohet janë përgjegjësi direkte administrativo-ligjore e strukturarave të posaçme të Bashkisë Dibër që paragesin për miratim project-akte të kësaj natyre.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR

KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 46 Date 03/06/2022

“Për një shtesë në Vendimin Nr.14 datë 08.04.2022 “Për miratimin e numrit të punonjësve të Administratës së Bashkisë Dibër, Institucioneve në vartësi dhe të Njësive Administrative për vitin 2022”

Mbështetur ne ligjin nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” neni 54, pika dh,në Ligjin nr.9936 datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, Ligji nr 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” të vendimin e Këshillit Bashkiak Dibër Nr.64 datë 24.12.2021 “Për Miratimin e Numrit të punonjësve të Administratës së Bashkisë Dibër, Institucioneve në vartësi dhe Njësive Administrative për vitin 2022. Vendimi Nr.14 date 08.04.2022 “Për një shtesë ne vendimin Nr.64 datë 24.12.2021 “Për Miratimin e Numrit të punonjësve të Administratës së Bashkisë Dibër, Institucioneve në vartësi dhe Njësive Administrative për vitin 2022”, Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës 03.06.2022 me 21 vota pro, 0 kundër dhe 0 apstenim:

VENDOSI:

- I. Një shtesë në vendimin Nr.14 datë 08.04.2022 “Për miratimin e numrit të punonjësve të Administratës së Bashkisë Dibër, Institucioneve në vartësi dhe të Njësive Administrative për vitin 2022”
- II. Shtimin e numrit të punonjësve të Bashkisë Dibër me 30 (tridhjetë) pozicione me kontratë pune të përkohshme mujore (7 muaj) për punë sezonale sipas relacionit bashkangjitur.
- III. Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Sherbimeve Mbeshtetese dhe Drejtoria Ekonomike pranë Bashkisë Dibër.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit për bazueshmëri ligjore nga institucioni i Prefektit të Qarkut Dibër.

Kryetar Këshilli

Sokol Sava



Adresa: | Bulevardi “Elez Isufi” Peshkopi | email: bashkiadiber@gmail.com | tel: 0035521822935



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR

DREJTORIA E SHERBIMEVE MBESHETTESE
PROJEKT-VENDIM

Nr. 03 Date 26/05/2022

“Për një shtesë në Vendimin Nr.14 datë 08.04.2022 “Për miratimin e numrit të punonjësve të Administratës së Bashkisë Dibër, Institucioneve në vartësi dhe të Njërive Administrative për vitin 2022”

Mbështetur ne ligjin nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” neni 54, pika dh,në Ligjin nr.9936 datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, Ligji nr 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” vendimin e Këshillit Bashkiak Dibër Nr.64 datë 24.12.2021 “Për Miratimin e Numrit të punonjësve të Administratës së Bashkisë Dibër, Institucioneve në vartësi dhe Njërive Administrative për vitin 2022. Vendimi Nr 14 date 08.04.2022 “Për një Nr.64 datë 24.12.2021 “Për Miratimin e Numrit të punonjësve të Administratës së Bashkisë Dibër. Institucioneve në vartësi dhe Njërive Administrative për vitin 2022”

KËRROJMË:

- I. Një shtesë në vendimin Nr.14 datë 08.04.2022 “Për miratimin e numrit të punonjësve të Administratës së Bashkisë Dibër, Institucioneve në vartësi dhe të Njërive Administrative për vitin 2022”
- II. Shtimin e numrit të punonjësve të Bashkisë Dibër me 30 (tridhjetë) pozicione me kontratë pune të përkohshme mujore (7 muaj) për punë sezonale sipas relacionit bashkangjitur.
- III. Pakësohet fondi i planifikuar për Këshillin Bashkiak në zërin e shpenzimeve operative dhe fondi rezervë në vlerën 5.280.000 (Pesë milion e dyqind e tetëdhjetë mijë) dhe shtohet struktura e shërbimeve publike 6260 në vlerën 5.280.000 (Pesë milion e dyqind e tetëdhjetë mijë).
- IV. Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Sektori i Financës pranë Bashkisë Dibër.
- V. Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit nga ana e Këshillit Bashkiak Dibër dhe shprehjes për bazueshmëri ligjore nga institucioni i Prefektit të Qarkut Dibër.

PËR BASHKINË DIBËR:

Përgjegjëse e Burimeve Njerëzore

Malbora Lala



Drejtori Ekonomik

Lorenc Cibaku



Përgjegjëse e Sektorit Juridik

Elona Lusha,



KRYETARI I BASHKISË

Rahim SPAHIU





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR

DREJTORIA E SHËRBIMEVE MBËSHPETËSE
RELACION

Me të dhëna të grupuara, për një shtesë në Vendimin Nr.14 datë 18.04.2022 “Për miratimin e numrit të punonjësve të Administratës së Bashkisë Dibër, Institucioneve në vartësi dhe të Njësive Administrative për vitin 2022”

KËSHILLIT TË BASHKISË DIBËR

Në zbatim të dispozitave të ligjit.139 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 54, “*Dejrat dhe kompetencat e këshillit bashkiak*” pika “dh”, citohet “*miraton buxhetin dhe ndryshimet e tij. Në vendimin për miratimin e buxhetit miraton, gjithashtu, edhe numrin e maksimal të punonjësve të bashkisë, si dhe të njësive e institucioneve buxhetore në vartësi të bashkisë; Kërkojnë nga ana juaj shtimin e numrit të punonjësve sezonal me 30 pozicione për një periudhë 7 mujore si pasojë e kërkesave të ardhura pranë Sektorit të Burimeve Njerëzore .*

Njësitë Administrative për mirëmbajtjen e Objekteve dhe rehabilitimin e rrugëve kërkojnë personel shtesë per **10 punonjes sezonal**.

Drejtoria e shërbimeve publike ka si mision të ofrojë shërbime publike të vazhdueshme e të përmirësuara për të gjithë komunitetin e bashkisë Dibër ,të ngrejë në nivelin e kërkesave të kohës, interesave dhe kulturës qytetare të gjitha shërbimet publike, të cilat kanë të bëjnë me përmirësimin e jetës së qytetarit. Kjo drejtori është e organizuar në 3 sektorët : Sektori i menaxhimit të mbetjeve dhe gjelbërimit ; Sektori i ndricimit public , ngrohjes dhe dekorit dhe sektori i mirëmbajtjes së objekteve dhe rrugëve.

Në drejtorinë tonë marrim shkresa/kërkesa të vazhdueshme nga qytetarë kryesisht të zonave rurale në lidhje kërkesat dhe nevojat për punëtorë në rrugë, mirëmbajtje objektivsh arsimore dhe administrative, shtirijen me shërbim në këto njësi sa i përket menaxhimit të mbetjeve dhe nevoja për punonjës për mirëmbajtjen e varrezave publike. Punonjësit që kemi në organikën e deritanishme nuk mjaftojnë për plotësimin e kërkesave të qytetarëve. Në këto kushte dhe duke u gjendur përpara kërkesës së vazhdueshme nga qytetarët për t’iu ofruar shërbimet e kërkuara kryesisht në sezonin e pranverë, verës dhe, vjeshtës dhe për tu ofruar këto shërbime përveç materialeve e mjeteve specifike duhet të na mundësoni një numër shtesë punonjësish sezonal prej **20 punëtorë**.

Shuma Totale e punonjësve te jete 880 (tetëqind e tetëdhjete) sipas tabelës së mëposhtme:

Funkzioni	Ishte	Bëhet
Punonjës te Administratës	486	486
Institucione ne Yaresi	74	74
Funksione te Deleguara	260	260
Punonjës Sezonal me Kontrata 7 Muaj	30	60
Shuma Totale M.B.NJ	830	880

Punonjës Sezonal do të jenë më shumë në numër. Nga 30 punonjës që janë aktualisht kërkojmë të bëhen 60 punonjës .Shtesa prej 30 punonjësish specifikohet si më poshtë:

- Për nevojat e Njësive Administrative për Mirëmbajtjes dhe rehabilitim e Rrugëve kërkojmë punësimin e **10 punonjësve** sezonal.
- Për nevoja të Drejtorisë së Shërbimeve Publike kërkojmë **20 punonjës** sezonal .

Me qëllim rritjen e efikasitetit dhe përdorimit sa më racional të burimeve njerëzore është e domosdoshme shtimi i numrit aktual të punonjësve sezonal duke i dhënë përparësi offimit të shërbimeve publike dhe shmangien e problemeve nga mungesa e personelit .

Duke shpresuar në mirëkuptimin e anëtarëve të Këshillit Bashkiak për një shtesë në Vendimin Nr.14 datë 18.04.2022 “Për miratimin e numrit gjithsej të punonjësve të Administratës së Bashkisë Diber Institucioneve në vartësi dhe të Njësive Administrative për vitin 2022”.

Përgjegjëse e Burimeve Njerëzore

Malbora LALA

